

THANAS FEKA

FJALORI I TERMAVE TË BANKËS

Serisë së fjalorëve terminologjike disagjuhësh të botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë iu shtua edhe “Fjalori i termave të bankës (shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht)”, i cili doli nga shtypi pak kohë më parë. Ky Fjalor është i teti në serinë e fjalorëve terminologjike për fushën e ekonomisë dhe i tridhjetedyti në serinë e fjalorëve terminologjike të fushave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore të botuar nga ky institucion. Ai është hartuar nga prof. Orfea Dhuci e prof. Lavdosha Zaho (specialistë) dhe prof. Hëna Pasho (gjuhëtare); redaktorë të veprës janë prof. Hëna Pasho dhe prof. Orfea Dhuci.

Si gjithë fjalorët e mëparshëm të kësaj serie, ai ka ndjekur të njëjtat synime e kriterë për përcaktimin dhe njësimin e terminologjisë së gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të fushës së veprimtarisë bankare në veçanti, të cilat janë mbajtur parasysh në përzgjedhjen dhe përcaktimin e termave që duhej të përfshiheshin në korpusin e Fjalorit, si edhe në realizimin sa më shkencor e kërkesave terminologjike për hartimin e tij.

Duke qenë një fushë me rreze të gjerë veprimi, termat e së cilës përdoren jo vetëm nga specialistët, por edhe nga një rreth i gjerë njerëzish jospecialistë, lënda terminologjike për termat kryesorë, që duhen përzgjedhur për t’u përfshirë në Fjalor, është vjelë nga dokumente, tekste mësimore, periodikë ekonomikë dhe nga botime të organizmave dhe të organizatave të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare për problemet e veprimtarisë bankare.

Në përzgjedhjen e termave kryesorë që janë përfshirë në këtë Fjalor, autorët kanë pasur si kriter bashkëkohorësinë dhe shpeshësinë e përdorimit në komunikim e në botime. Kryesisht janë terma që emërtojnë kategori dhe koncepte kryesore të fushës së veprimtarisë bankare, si: *arkëtim*, (*arkëtim i çekut*, *arkëtim i interesit* etj.), *bankë* (*bankë agjente*, *bankë bijë*, *bankë drejtuese*, *bankë e autorizuar*, *bankë hipotekore*, *bankë shëtitëse* etj.), *bashkëkreditor*, *çek* (*çek i hapur*, *çek i mbushur*, *çek i paradatuar*, *çek i vërtetësuar* etj.), *debitor*, *deflacion*, *depozitë* (*depozitë e çekueshme*, *depozitë ndërbankare* etj.), *depozitëlënës*, *dhënëshmëri* (*dhënëshmëri efektive*, *dhënëshmëri rrjedhëse* etj.), *garanci* (*garanci bankare*, *garanci rrjedhëse* etj.), *hua* (*hua me interes*, *hua ndërbankare* etj.), *indeksim* ose *treguesim* (*indeksim i monedhës*, *indeksim i normës së interesit* etj.), *inflacion* (*inflacion bankar*, *inflacion i përsheptuar* etj.), *interes* (*interes bankar*, *interes i kapitalizuar* etj.), *kambial* (*kambial i bankueshëm*, *kambial i dorëzuar* etj.), *kartëkredi*, *kartëdebi*, *këst*, *kolateral*, *kredi* (*kredi e lirë*, *kredi e ngrirë*, *kredi*

në të bardhë etj.), kreditim, kreditor, marzh ose hapë, monedhë (monedhë ari, monedhë e butë, monedhë e dobët, monedhë e drejtuar, monedhë e fortë, monedhë e kthyeshme, monedhë e shportës etj.), monetarizëm, ndërmjetës (ndërmjetës burse, ndërmjetës në këmbim valutor etj.), ndërmjetësim bankar, ndryshueshmëri e normës së interesit, normë (normë inflacioni, normë interesi bankar etj.), obligacion (obligacion hipotekor, obligacion i garantuar etj.), para (para e drejtuar, para elektronike, para e fjetur, para ligjore, para e lehtë etj.), portofol (portofol huash, portofol i diversifikuar ose portofol i ndryshmuar etj.), qarkullim (qarkullimi i parasë, qarkullim me kurs të detyrueshëm etj.), risk (risk kredie, risk monedhe, risk norme interesi etj.), shpinëzim ose prapanëshkrim (shpinëzim në të bardhë etj.), tarifë (tarifë bankare, tarifë e kombinuar etj.), tavan (tavan kredie, tavan norme, tavan interesi etj.), veprim (veprim këmbimi (valutor), veprim me çek etj.), vetësues, vlerë (vlerë çmuarje, vlerë e parasë etj.), zonë e monedhës, zhvlerësim i monedhës etj.

Krahas këtyre janë përfshirë në Fjalor, të grupuara më vete, edhe disa shprehje që përdoren në praktikën bankare, si: *me këste, me kreditim, në llogari rrjedhëse, në risk, pa interes, pa komision, për arkëtim, sipas kërkesës, para afatit etj.*

Në Fjalor janë ruajtur arritjet në terminologjitë e mëparshme e në fjalorët terminologjikë të mëparshëm, si p.sh.: (pasuri) *e luajtshme*, (pasuri) *e paluajtshme*, *vetësues, mëvitje etj.*

Në përbërje të termësit të Fjalorit ka mjaft terma të rinj, sidomos kompozita që nuk njihen ende në shqipen standarde, si: *rishqyrtim* për *audit*, *rishqyrtues* për *auditor*, *tejtërheqje* për *overdraft*, *përkthim (i monedhës)*, *borxhtar*, *pranueshmëri (e kambialit)*, *qëndrueshmim* për *stabilizim*, *i pasdatuar (çek i pasdatuar)*, (hua) *afatepshme*, (hua) *afatprerë*, (hua) *afatkaluar*, (kurs) *dynivelësh*, (kredi) *shumëmonedhëshe*, *obligacionmbajtës*, *pengmbajtje*, *urdhërarkëtim*, *kartë-kredi*, *mbetje-debi*, *financim-urë*, *monedhë-kyç etj.*

Këta terma të krijuar drejt sipas gjedheve fjalëformuese të gjuhës shqipe përbëjnë një pasurim jo vetëm për terminologjinë e bankës, por edhe për shqipen standarde, sepse ata potencialisht mund të bëhen pronë e saj dhe të mos ndihen më si neologjizma.

Në hartimin e termave komisioni hartues ka synuar të zgjidhë sa më drejt problemet themelore që lidhen me identitetin e secilit term të përfshirë në Fjalor, si: saktësimi i termit shqip dhe barasvlerësia kuptimore e tij me termin gjegjës në gjuhët e huaja përkatëse në të cilat është hartuar Fjalori. Kështu p.sh., janë dalluar kuptimisht në veprimtarinë bankare si dy terma më vete: *dorëzani* dhe *garanci*, *dhënshmëri* dhe *rendiment* etj. Një gjë e tillë është bërë edhe me togfjalëshat terminologjikë. Lidhur me këtë, në parathënien e

Fjalorit theksohet: “Është bërë saktësimi gjuhësor apo plotësimi i përbërësit të dytë në disa togefjalësha për ta dhënë saktë përmbajtjen, si: (bankë) *arkëtimi*, (bankë) *kreditimi*, (bankë) *përplotësimi*, por: (bankë) *paguese*, (bankë) *referuese*, (bankë) *pranuese*, duke dalluar kështu, veprimtarinë kryesore të bankës (me emrat e veprimit) nga një veprim i kryer në një rast të caktuar (me mbiemrat foljorë); aftësi *kreditimi*, aftësi *pagimi*, aftësi *shlyerje* në vend të: aftësi *kredituese*, aftësi *paguese*, aftësi *shlyese*; institucion *kreditimi*, kushte *kreditimi* në vend të: institucion *kredie*, kushte *kredie*; çmim *tregu*, e ardhur *portofoli* në vend të: çmim *i tregut*, e ardhur *e portofolit*; garanci *për hua*, garanci *për kredi*, garanci *për aftësi pagimi* në vend të: garanci *huaje*, garanci *kredie*, garanci *aftësie pagimi*; linjë *kredie në të bardhë* në vend të: linjë *kredie e bardhë*; pozicion *në këmbim (valutor)* në vend të: pozicion *valutor*; rakordim *i llogarive bankare* në vend të: rakordim *bankar*; përshpejtim *i ritmeve të inflacionit* në vend të: përshpejtim *i inflacionit*” etj.

Kujdes i veçantë është treguar gjatë punës hartuese të Fjalorit për barasvlerësinë kuptimore të termave të huaj. Duke qenë një fjalor shumëgjuhësh, përdoruesit presin të gjejnë në të barasvlerësit e saktë edhe në treguesit e katër gjuhëve të huaja. Këtë kërkesë të rëndësishme të domosdoshme komisioni hartues e ka zgjidhur drejt duke zbatuar më së miri kriterin e vendosur që termat në gjuhët e huaja të mos përkthehen nga njëra gjuhë tek tjetra, por të vihen termat barasvlerëse që përdoren realisht në gjuhën përkatëse. Kështu, p.sh., në Fjalor për togefjalëshat terminologjikë *hua me kushte lehtësuese*, *hua me kushte tregu* janë vënë përkatësisht në anglisht barasvlerësit *soft loan*, *hard loan*. Madje, kur ka qenë e pamundur të gjendej termi barasvlerës në gjuhë të huaj, është parapëlqyer më mirë që ai të mos jepej, sesa të përkthehej, për të mos ia cenuar kështu Fjalorit vërtetësinë dhe vlerat shkencore lidhur me gjegjëset reale në gjuhët e huaja.

Dihet që sa më i shkurtër të jetë termi, aq më lehtë hyn ai në përdorim. Kjo kërkesë e termit është mbajtur parasysh nga komisioni hartues. Kështu, në ato raste kur ka qenë e mundur, disa togefjalësha të thjeshtë terminologjikë janë kthyer në kompozita sipas gjedheve fjalëformuese të shqipes, si: (hua) *afatëshme*, (hua) *afatprerë*, (hua) *afatkaluar*, (kredi) *shumëmonedhëshe*, *dëftesëpagim*, *urdhërarkëtim*, *obligacionmbajtës*, *kartë-kredi*, *inflacion-bazë*, *monedhë-kyç* etj.

Dihet gjithashtu që terminologjia synon drejt standardizimit. Këtë funksion normativ ky Fjalor e përmbush më së miri, duke përcaktuar e rekomanduar termin që duhet përdorur. Komisioni hartues i ka kushtuar vëmendje të veçantë mënjanimi të termave të huaj të panevojshëm në shkallën më të mundshme, si: *kambist*, *borxh i konsoliduar*, *bankë korrespondente*, *fleksibilitet* i kursit të këmbimit, *kredie e konfirmuar*, *konvertibilitet* i monedhës, të cilat janë zëvendësuar përkatësisht me: *këmbyes*,

borxh *i përforcuar*, bankë *gjegjëse*, *epshmëri* e kursit të këmbimit, kredi *e pohuar*, *kthyeshmëri* e monedhës.

Termet e huaj që këshillohen të mos përdoren janë referuar me shënimin *shih*.

Edhe për disa terma që kanë hyrë nga anglishtja dhe po përdoren jo pak në veprimtarinë bankare, si p.sh.: *audit*, *auditor*, *kolateral*, *overdraft*, *tender* janë gjetur ose janë krijuar fjalë të reja si barasvlerës shqip ose pjesërisht shqip: *rishqyrtim*, *rishqyrtues*, *garanci-shtesë*, *tejtërheqje*, *ofertë sipërmarrjeje*.

Disa terma të shqipëruar janë lënë në Fjalor si sinonime krahas termit të huaj, si: *ekspansion* i kredisë ose *zgjerim* i kredisë, hua *e indeksuar* ose hua *e treguesuar*, *marzh* ose *hapë*, *diversifikim* (i portofolit) ose *ndryshim* (i portofolit).

Në këtë punë të vlerësueshme për pastrimin e mëtejshëm të terminologjisë së bankës komisioni hartues ka shfrytëzuar të gjitha rrugët e mundshme: duke ngritur në nivel termi, si pjesë përbërëse të togfjalëshave terminologjike, fjalë të zakonshme të gjuhës si: *tavan* (borxhi), (kapital) *i fjetur*, (borxh) *i shartuar*, *ngrirje* (kredie), *rrjetë* (monetare), *shportë* (monedhash) etj.; duke krijuar fjalë të reja, sidomos me anë të prapashtesave -*im*, -*je*, -*s*, që kanë prirjen për t'u specializuar në formimet e karakterit terminologjik.

Besojmë se ky Fjalor, me vlerat që ngërthen, do të ndihmojë ndjeshëm në përpunimin, njësimin dhe shqipërimin e mëtejshëm të terminologjisë së bankës; ai përbën njëherazi një bazë të shëndoshë për hartimin e një fjalori më të plotë në të ardhmen, që mund të lindë si një nevojë e natyrshme, për t'i përgjigjur sa më mirë zhvillimeve të vazhdueshme terminologjike të veprimtarisë bankare.